

VENDIM
Nr.259 datë 7.6.1993

PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të ligjit të urbanistikës nr.7693, datë 6.4.1993, kreu II, neni 7, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Këshillit të Territorit të Shqipërisë (KRRTSH) pranë Këshillit të Ministrave.
2. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë është organ vendimor dhe miraton studime të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të urbanistikës.
3. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë përbëhet nga 17 anëtarë.
4. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë ka këtë përbërje:
 - a) Kryetari i Këshillit të Ministrave - kryetar i KRRTSH
 - b) Ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit – zëvendëskryetar i KRRTSH.
 - c) Drejtori i Drejtorisë së Rregullimit të Territorit - sekretar i KRRTSH.
 - ç) Anëtarë të KRRTSH nga Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Turizmit, Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Komiteti i Mbrojtjes së Mjedisit, lista emërore e të cilëve miratohet nga kryetari i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Shqipërisë.
5. Drejtoria e rregullimit të territorit në Ministrinë e Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit kryen funksionin e sekretarisë teknike të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Shqipërisë.
6. Mbledhja e KRRTSH drejtohet nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendëskryetari.
7. Këshilli i Rregullimit të territorit të Shqipërisë funksionon sipas rregullores përkatëse të tij, miratuar nga kryetari i KRRTSH.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

R R E G U L L O R E

PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË TERRITORIT TË SHQIPËRISË

Rregullorja e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Shqipërisë është mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.259, datë 7.6.1993, ku përcaktohet ngritja dhe funksionimi i KRRTSH.

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë mbledhet një herë në muaj, si rregull, javën e parë të çdo muaji. Në raste të veçanta, kur e gjykon të arsyeshme kryetari i KRRTSH, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë mbledhet edhe jashtë radhë.

Për çdo material që shqyrton KRRTSH, dokumentacioni i plotë dorëzohet në sekretarinë teknike të KRRTSH, që është drejtoria e Rregullimit të Territorit në Ministrinë e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Materialet që shqyrtohen në KRRTSH, dorëzohen në sekretarinë teknike 21 ditë para mbledhjes. Sekretaria teknike i shqyrton ato, bën opionencën dhe jep mendimin e saj për materialin e paraqitur. Kur materialet e paraqitura për shqyrtim nuk i plotësojnë kushtet teknike dhe nuk kanë nivelin e duhur të paraqitjes, sekretaria i kthen për plotësim.

Sekretaria e KRRTSH regjistron në një regjister të veçantë materialet që dorëzohen për shqyrtim në mbledhje.

Sekretaria përgatit materialin përmbledhës, i cili do të shqyrtohet në KRRTSH dhe, bashkë me

njoftimin e datës së mbledhjes, ia shpërndan anëtarëve të KRRTSH 5 ditë para mbledhjes.

Mbledhja e KRRTSH zhvillohet me pjesëmarrjen e dy të tretave të anëtarëve dhe vendimi merret me shumicë votash.

Pas shqyrtimit të materialeve të KRRTSH, një kopje e dokumentacionit arkivohet në arkivin e Këshillit të Ministrave, një kopje në arkivin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit bashkë me procesverbalin e mbledhjes, si dhe kopjen e vendimit të firmosur nga kryetari ose zv.kryetari i KRRTSH.

KRYETARI I KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË
TERRITORIT TË SHQIPËRISË
Aleksandër Meksi